



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3085Prot.

Shijak, më 25 .07 .2024

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Lloji i diplomës “ Drejtësi ” niveli minimal i diplomës “Bachelor”

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Bashkia Shijak shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionet:

- 1 Specialist (jurist)

në Drejtorinë Juridike , Kategoria e pagës IV-a.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!
Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

**Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil)
aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 08.08.2024	Lëvizje paralele
Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 13.08.2024	Pranim në shërbimin civil

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Hartimi i projekt-akte juridike dhe rishikimi akteve juridike të Bashkisë.

Harton dhe përgatit korrespondencat administrative me strukturat e tjera organizative të bashkisë në përmbushje të punës dhe detyrave të ngarkuara nga Kryetari i bashkisë ose Sekretari i Përgjithshëm/Drejtori/.

Jep këshillim juridik të vazhdueshme tek të gjithë njësitë e tjera organizative të përfshirë në procedurat kontraktore, gjyqësore apo ligjore, në përmbushje të kërkesës së Drejtorit.

Ndjek në të gjitha shkallet e gjykimit çështje gjyqësore të ngarkuara, në të cilat bashkia është palë ndërgjyqëse.

Informon Drejtorin për të gjitha ndryshimet, problematikat dhe ecurinë e proceseve gjyqësore.

Harton dhe ndjek korrespondencat me të tretët në funksion të mbrojtjes së interesave të bashkisë.

Bashkëpunon me strukturat e tjera të Bashkisë, lidhur me interpretimin e akteve ligjore të natyrave të ndryshme.

Harton dhe përgatit brenda afatit ligjor ankimet, rekurset, kërkesat e pezullimit të ekzekutimeve dhe çdo mjet tjetër ligjor në funksion të çështjeve për të cilat është e ngarkuar dhe autorizuar.

Kryen çdo detyrë tjetër që i caktohet nga Drejtori.

I-LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori IV-a .
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv ;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor”, në fushen e Drejtesise
Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- c) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Shijak ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
- b) <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>

- c) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i) Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 08.08.2024.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 12.08.2024 njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Shijak ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar .
- d) Njohuritë mbi Kodin e Proçedurave Administrative .
- e) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- f) Kodi civil i Republikës së Shqipërisë
- g) Kodi i proçedurës civile i Republikës së Shqipërisë

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Shijak do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në fushën e Drejtësisë .
Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.

- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- c) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
- b) <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c) Fotokopje të diplomës;
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i) Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 13.08.2024 , në Institucionin Bashkia Shijak.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 15.08.2024 , njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Shijak , ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- c) Njohuritë mbi Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar .
- d) Njohuritë mbi Kodin e Proçedurave Administrative .
- e) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- f) Kodi civil i Republikës së Shqipërisë
- g) Kodi i proçedurës civile i Republikës së Shqipërisë

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Shijak do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

KRYETARI

Elton Arbana





REPUBLIKA SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3085/1 Prot.

Shijak, më 25.07.2024

Lënda: Kërkesë për publikim vendesh të lira.

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT
Tiranë

Bashkia Shijak ka vendosur të shpallë procedurën e konkurimit për pozicionin e shpallur për konkurim, "Lloji i diplomës " Shkenca Shoqërore ".

Për këtë arsye, në përputhje me Ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në bazë e në zbatim të tij, kërkojmë publikimin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit".

Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën përkatëse për publikim.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Elton Arbana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3085/Prot.
3

Shijak, më 12 .08 .2024

Lënda: **Kërkesë për publikim**

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Tiranë

Bashkia Shijak ,në zbatim të nenit 25 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka përfunduar procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil, për grupin e pozicioneve të shpallura për konkurrim, “Lloji i diplomës “ Drejtësi ” pa kandidatë të përzgjedhur.

Për sa më sipër, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, procedurën e mësipërme .

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Elton Arbana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3085/ Prot.
2

Shijak, më 12.08.2024

NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK
PËR LËVIZJE PARALELE
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)

Lloji i diplomës “ *Drejtësi* ” niveli minimal i diplomës
“Bachelor”

Në zbatim të nenit 25 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndyshuar, si dhe të Kreut VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Për pranimin , lëvizjen paralele , periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive ”, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Shijak , në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele dhe kërkesave të veçanta të shpallura në shpalljen për konkurrim, njofton se pozicionin e mësipërm nuk ka kandidatura të përzgjedhura .

Për sa më sipër njoftojme kandidatet se pozicioni është i hapur për procedurën e pranimin në shërbimit civil.

KRYETARI
Elton Arbana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3085/5 Prot.

Shijak, më 15.08.2024

Lënda : Kërkesë për publikim të listës së kandidatëve

SHËRBIMIT KOMBETAR TË PUNËSIMIT

Tiranë

Bashkia Shijak në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.152/2013 , “ Për nëpunësin civil ” , i ndryshuar , ka përfunduar procedurën e pranimit në shërbimin civil , për pozicionin e shpalluar për konkurrim , “ Lloji i diplomës “ Drejtësi ”

Për sa më sipër , bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim në portalin “ Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimin e civil .

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin ,

KRYETARI
Elton Arbana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3085/4 Prot.

Shijak, më 15.08.2024

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT
PARAPRAK
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)**

**Lloji i diplomës “ Drejtësi ” niveli minimal i diplomës
“ Bachelor ”**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Shijak, në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të pranimit në shërbimin civil dhe kërkesave të veçanta të shpallura në shpalljen për konkurrim, njofton se kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të testimit , janë :

1. Denisa Beqiri

Testimi me shkrim do të zhvillohet , në ambjentet e Bashkisë Shijak , me datë 29.08.2024 ora 14.00 , kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlersimin me shkrim më shumë se gjysmën e pikëve do të kalojnë në intervistën e strukturuar me gojë.

KRYETARI
Elton Arbana



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3085/8 Prot.

Shijak, më 30.08.2024

**NJOFTIM FITUESI
PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)**

Në zbatim të nenit 22 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe të Kreut II, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Njësia përgjegjëse në Bashkinë Shijak në përfundim të procedurës së pranimin në shërbimin civil, njofton se kandidati fitues për grupin e pozicioneve:

Lloji i diplomës “ Drejtësi ” niveli minimal i diplomës “Bachelor”

1. **Znj. Denisa Beqiri**

KRYETARI
Elton Arbana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3085 Prot.
79

Shijak, më 30 . 08 .2024

VENDIM

NR 242 DATË 30 / 08 /2024

“ PËR EMËRIM NË PUNË ”

Bazuar në ligjin nr. 152/2013 “ Për nëpunësin civil ”, i ndryshuar , neni 23 , dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243 datë 18.03.2015 “ Për pranimin , lëvizjen paralele , periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive ”,

VENDOS

1. Të emëroj nëpunës në periudhë prove Znj.Denisa Beqiri në pozicionin , Specialist (jurist) në Drejtorinë Juridike , Bashkia Shijak .
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

DREJTOR I DMBNJ
Ermira Shehi

KRYETARI
Elton Arbana

